

Procesverbal

Nga Mbledhja VII (e shtatë) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 28.07.2025

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e shtatë të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e shtatë të rrëgullt të KPF-së! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë! I kemi tri pika të rendit të ditës. Për në seancë janë paraparë shtatë pika të rendit të ditës dhe pika eventuale. Nëse keni diçka rreth rendit të ditës së KPF-së, mund ta merrni fjalën.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Kërkoj falje, se këtë e kam pas për në eventuale, por për shkaqe të angazhimeve të mia familjare, po dua me e thënë në pikë të rendit të ditës. Znj.Kryesuese dhe z.kryetar, unë para se me u bo pika e rendit të ditës edhe me u caktue seanca, e kam bo një kërkesë te kryesuesja, se e kam një aheng familjar nesër, e martoj vajzën, edhe kam kërkuë që nesër të jam prezent unë aty, të shtyhet një ditë përpara ose mbrapa, nuk kam gjet mirëkuptim nga ju, as nga kryetari e as nga kryesuesja. Në emër të familjes – kryesuesja bile është e thirrur atje edhe si shoqe e jemja, edhe e punës, edhe si bashkëfshatare, por edhe në emër të shoqes sime është e thirrur nesër në atë ahengun tim, edhe ju kryetar si staf. Por, këtë nuk ma keni bo mirë, kjo është krejt personale, s'un kam gjet mirëkuptim. Për qëndrimet tua edhe të LDK-së e di që ju pengon prezenca ime këtu me qenë edhe si asambleist, po edhe si qytetar, edhe si përfaqësues i popullit, por me kryesuesen shumë një hatërmbetje të madhe e kam. Është send që nuk i falet! I kam kërkuë përpara, i kam çue kërkesë – e martoj vajzën, kam aheng, ju me m'përkrah – e ju e qitni seancën me qëllim. Mos ju paça borxh as njërit, as tjetrit, e sidomos kryesueses! Një fjalë e urtë popullore thotë: Kur ka shkue sëpata në mal, edhe i ankohet malit sëpata, i thotë po më presish, po s'ke faj i thotë ti se ta kam dhënë bishtin. Edhe unë ta kam dhënë votën me u ulë sot qaty ti, të kam mbështet ma shumë se LDK-ja, të kam pas shoqe të shkollës, të kam pas shoqe të punës, të kam pas kojshi e krejt, jam befasue me ty, mos qofsha në lëkurën tënde! Ishalla unë prapë ta kthej me të mirë ty, veç kjo çdo sene mundet me qenë, veç njerëzore nuk është. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! E para, nuk kam pas kërkesë, asnjë kërkesë nuk e kam pas që z.Artan Loshaj ka darsëm. Po, ai shkon, se nuk ka asnjë argument. Mu nuk më ka bo kërkesë, as nuk e kam

ditë. Edhe ti, kryetar, në qoftë se ti ke pas kërkesë ... unë nuk kam pas kërkesë që ka darsëm. Masi e kam shpallë, kur kam ardhë me e nënshkrue rendin e ditës që e kemi bo, Suadi më ka thënë para dy javëve më ka thënë Artani me gojë që a mundesh me i thënë kryesueses që për mos me e mbajt më 29 korrik. Masi ai paska qenë koleg, masi paska qenë shok, pse s'ma ka bo një telefonatë mu? E dyta, masi e kam qit rendin e ditës, nesrit gruaja e Artanit – masi i ka bo krejt ftesat një javë përpara, atë ditë kur e ka pa seancën që e kemi, ma ka bo ftesën. Unë absolut nuk i kërkoj falje. Unë asnjë kërkesë nuk e kam, as zyrtare, as në telefon, askund. Edhe na nuk ia dimë datën kur është. Kemi pas na shumë asambleist që kanë thënë a mundish me ma ndryshue datën se e kam darsmën, i kam thënë s'është problem. Më ka thirrë Anesa, më kanë thirrë edhe dy vetë tjerë për caktim të darsmave familjare, edhe edhe unë nuk jam kundër këtyre. Logjika nuk e rrok këtë. Edhe aq ma pak na jemi kojshi. Në qoftë se ka Artani ndonjë fakt që mu më ka bo kërkesë zyrtare, ose në telefon, unë haptaz dal. A, në lëkurën e tij unë mos qofsha!

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, të nderuar anëtarë të KPF-së! I nderuar nënkryetarë, drejtorë! M'u përmend emri edhe mu nga ana e Artanit. Unë sot po ndij për herë të parë që ai paska nesër darsëm, a po e marton djalin a vajzën, nuk e kuptova mirë. Kështu që, nesër darsëm, nuk thirret sot këtu në foltore me m'thirrë mu. Po më duke shumë si absurde, edhe nuk është e vërtetë që mu më ka lajmëruë Artani që nesër ka aheng familjar. Unë sot kuptova që ai paska diçka. Faleminderit!

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderuar delegatë! Përderisa ke qenë e informuar, znj.kryesuese, përmes Suadit – pa marrë parasysht që s'e ka bo kërkesën...

Arijeta Skeraj: Masi e kam nënshkruar rendin e ditës, qe është Suadi këtu, mos bën politikë edhe ti për një darsëm! As edhe e informuar nuk kam qenë. Të lutem! Masi është caktuar data, unë ta ndryshoj, kur ai mu më ka kolege, ka mund një telefonatë me ma bo. Ai e ka ditë që në fund të korrikut kemi me pas seancë. Po dësh me bo shumë politike, po më vjen keq!

Uran Halimi: Politikë nuk jam duke bo, se nuk ke media, mos u tut! Po unë politikan jam, pse, çka dashte ti? Unë nuk boj pica këtu. Kështu është puna: Të ka njoftue, hajt ta zëmë, masi e ke thirrë seancën. E ke pas atë mundësi një ditë me e shty ose mos me e shty, me një email, shumë thjesht. Ke mund me e çue një email – të nderum delegatë, me kërkesë të z.Loshaj po e shtyjmë seancën një ditë para ose mbrapa, nuk prish punë, meqenëse jemi koleë. Plus të ka votue edhe si kryesuese, edhe një votë e tij ka pas vlerë, e dish edhe ti shumë mirë, edhe e krejt Grupit Parlamentar të PDK-së. Për ne unë të thashë që nuk kish pas problem, po ke dasht tash me u faktorizue, sikur ai që thojke me rregulla të pashkruara, ai drejtori atje. Nuk është pa qare me i shkruë do rregulla që na mundemi me i bo edhe vetë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Sipas teje, Uran, rregulla me vu na për me e shty seancën për ahengje familjare, veç te ti e shoh. Për ahengje familjare me u shty seanca, kur ai ka pas mundësi që kur e ka caktue datën me

m'u lajmëruë mu si kryesuesë. Unë nuk e mohoj, ai më ka votue, veç edhe ai çka të dojë me bo, jo.

Uran Halimi: Epo, në rregull, kallxo që po duesh me kallxue autoritet. Në fillim thajë s'kam pas njoftim, tash po kallxojsh që po duesh me tregue autoritet.

Arijeta Skeraj: Jo, njoftim s'kam pas edhe kurr nuk e pranoj që kam pas. Por edhe falje nuk i kërkoj, se asnjë send nuk kam bo kundër. Ai tha duhesh me kërkue falje.

Uran Halimi: Unë nuk besoj që kërkimfalja ndryshon diçka. Sidoqoftë, bën si të duash!

Arijeta Skeraj: Këtë e kam të mirë, që nuk i kërkoj falje kur nuk jam gabim. Atëherë, e qesim në votim rendin e ditës. Kush është pro rendit të ditës të KPF-së? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë te pika e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo e hedhim në votim. Ku është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Vazhdojmë te materiali i seancës, te pika e dytë: Raporti i Auditorit të Jashtëm. A do dikush me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Kam dy pyetje për këtë mbledhje të sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa, lidhur me raportin e Auditorit. Në faqen 8 të raportit të Auditorit thuhet se nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë paguar 22.000 euro për punime ndërtimore. Pyetja ime është: për cilat punime ndërtimore konkretisht janë shpenzuar këto 22.000 euro, cilat janë emërtimet e atyre investimeve kapitale? Më tej, në të njëjtën faqe thuhet se 34.000 euro nga kategoria e investimeve kapitale janë shpenzuar për shpërblime jubiliare. Më intereson të di kush janë të punësuarit që kanë marrë shpërblime jubiliare në vitin 2024, dhe gjithashtu për këtë shumë prej 34.000 euro. Sepse e di që shpërblimet jubiliare janë shfuqizuar, se ajo vendim i Ministrisë së Arsimit është shfuqizuar. Prandaj dua të di se kujt i janë paguar këto shpërblime jubiliare. Ju faleminderit.

Bexhet Xheladini: Faleminderit për pyetjen! Për shpërblimet jubilarë, është fjala për kontratën kolektive. Ndërsa, 22 mijë euro nga Mallrat dhe Shërbimet që janë paguar investime kapitale, janë të vërsimeve të vitit të kaluar. Ju e dini që ne kemi prit që Qeveria do të bëjë pagesën e dëmeve në infrastrukturë, ajo nuk e ka bërë dhe ne atëherë kemi ndarë mjete nga Mallrat dhe Shërbimet, i kemi mbulue disa projekte. Por, nesër ne mujm edhe me pru dokument për këtë punë.

Uran Halimi: Kryetari tha që, meqenëse nuk janë mbuluar shpenzimet nga Qeveria, i kemi mbulue na vetë. A ka mundësi, kryetar, me e saktësue, çka përfaqësisht keni mbulue me këto shpenzime. Te vërsimet, ku, në cilën pjesë kanë shkue këto pare, cila zonë ose çka u ndreq me qeto pare?

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e tretë: Plani i Veprimit të Auditorit të Jashtëm. A do dikush rreth kësaj pike me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe

këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Raporti Financiar i Shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2025. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Munir Jonuzi: Lidhur me këtë raport, raportin gjashtëmujor financiar, do të ndalem vetëm te lista e përfituesve të subvencioneve që gjendet në faqen e shtatë. Më intereson pse kjo listë e përfituesve të subvencioneve nuk është e plotë. Në atë listë nuk figuron OJQ “Milina”, nuk figuron OJQ “Star”, nuk figuron ai “InterTotoClub”. Pse këta nuk janë përfshirë në këtë raport? Dhe pyetja e dytë, më intereson sa në të vërtetë ka marrë organizata joqeveritare “BISER” në emër të subvencioneve nga komuna. Në këtë raport thuhet se janë tre mijë, mirëpo në faqen zyrtare të komunës është publikuar se shuma është katër mijë. Prandaj më intereson, a është e saktë shifra tre apo katër mijë, sepse po marrim informata të ndryshme. Nëse e dimë që ju, z. Kryetar, keni nënshkruar kontratë me të gjitha këto organizata joqeveritare më 24 qershor, përkatësisht më 26 qershor me “Rininë Demokratike GORA”, e cila është në këtë tabelë, atëherë pse nuk i kemi OJQ “Milina”, OJQ “Star” dhe “InterTotoClub”?

Bexhet Xheladini: Sa i përket asaj se pse nuk janë të përfshira të gjitha OJQ-të në raportin gjashtëmujor, disa OJQ-ve u është krye pagesa para 30 qershorit, disave u janë krye në muajin e shtatë, për atë nuk janë të gjitha. Edhe sa i përket OJQ-së Milinja, komisioni herën e parë ia ka ndarë 3 mijë euro, pastaj ajo ka bërë ankesë, edhe Komisioni i Ankesave ia ka rrit edhe 1 mijë euro, dhe i ka 4 mijë euro. Apo “Biser”, nuk e di, njëra prej tyre, sepse dy vetëm janë ankuar prej të gjithave, Komisioni këtyre djave ua ka rrit nga 1 mijë euro. Ne nuk kemi mundur këtë 1 mijë euro me ia pague, për arsye se në Buxhetin e vitit 2024 për Drejtorinë e Kulturës kanë qenë të parapara 140 mijë euro, ndërsa me këto dy vendimet që i ka marrë Komisioni për Ankesa janë bërë 142 mijë euro. 2 mijë euro do të merren nga Subvencionet e kryetarit këtë muaj dhe do t’u paguhen atyre.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e katërt. Vazhdojmë te pika e pestë: Informatë lidhur me punën e KKS-së për periudhën janar-qershor 2025. A do dikush me e marrë fjalën lidhur me këtë pikë? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e pestë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë: Rishqyrtimi i Vendimit 01Nr.060/01-11859-2/25 të datës 30.06.2025 për miratimin e Listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Dragashit. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e shtatë: Shqyrtimi i kërkesës së z.Burim Piraj për ndërrimin e destinimit të tokës. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Uran Halimi: Meqenëse ne e kemi pas një rast për ndërrim të destinimit të tokës, edhe gjatë asaj kohe

e kam vërejt që ne nuk kemi të drejtë me ndërrue destinim të tokave private. Nëse keni mundësi me ma dhënë një sqarim, a kemi të drejtë ne me u marrë me prona private, meqenëse jemi Kuvend Komunal edhe mujm me i ndërrue destinim pronave të Komunës, e jo pronave të njerëzve privatë. Me ma dhënë një sqarim, kushdoqoftë, nuk është problem.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë të KPF-së, pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Përshëndetje, znj. Kryesuese, nuk kam asnjë pyetje. Vetëm desha të përgëzoj Drejtorinë për Shërbime Publike, drejtorin Rexhep Ibrahim, i cili është drejtori i parë që më ka nderuar dhe më ka kthyer përgjigje në kërkesën time. Si zëvendëskryesues i Kuvendit tash katër vite, për herë të parë marr përgjigje nga një drejtor. Dhe e falënderoj për këtë. Jo pse është ushtrues detyre, por sepse ai e kryen punën e tij me përgjegjësi. E falënderoj.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e mbyllim këtë Komitet! Shihemi nesër në seancë!